

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel akademik pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel akademik në pozicionin “Asistent Lektor” në Departamentin e Elektroteknikës për:

1. Lëndët “Elektroteknikë 1”, “Elektroteknikë 3”, në FIE, FTI
2. Lënda “Impiante” në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave
3. Lënda “Elektroteknikë” në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike

Kriteret e kandidatit për punësim:

- Të ketë përfunduar studimet universitare në Inxhinieri Elektrike, në ciklin “Bachelor” dhe “Master i Shkencave”, ose në sistemin 5-vjeçar.
- Të ketë notë mesatare të ponderuar për të dy ciklet e studimit më të lartë se 8.0, në rastin e diplomës “Master i Shkencave”, ose notë mesatare 8.0, në rastin e përfundimit të sistemit 5-vjeçar.
- Të ketë mesatare notash mbi 8.0 në lëndët:
 - Matematikë (Analizë Matematike I, II; Algjebër; Analizë Komplekse),
 - Fizikë (Fizikë Eksperimentale I, II),
 - Elektroteknikë (Elektroteknikë I, II, III),
 - Teori e Fushës Elektromagnetike.
- Kanë përparësi kandidatët që zotërojnë tituj akademikë, si dhe personeli akademik me kohë të pjesshme pranë Departamentit të Elektroteknikës, me përvojë mbi dy vite.
- Përbën përparësi eksperiencia në mësimdhënie në lëndë të njëjta ose të ngjashme.
- Kandidati duhet të jetë i komunikueshëm, i aftë për punë në grup dhe të demonstrojë etikë profesionale.
- Kandidatët që aplikojnë për herë të parë preferohet të paraqesin rekomandime nga departamenti ku janë diplomuar ose nga vendi aktual i punës.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimi (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **20.02.2026** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.